KËRKESË
Nr.1159/1, datë 12.4.2010

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Ura E Gajdarit-Rrap", (Rruga Hyrëse Sarandë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkese për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit "truall dhe objekte" (karabina, objekte banimi, dyqan). Pasuria në emër të pronarëve Agim Dule, Avdul Dule dhe Musa Musai do të kompensohen pasi të kenë përfunduar regjistrimin e pasurisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës. Ndërsa pasuritë në emër të z. Thanas Vaho Naci, Xhemal Resul Cepe dhe Sheko Mine Xhuvani do të kompensohen pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit të pasurive që ata disponojnë, si dhe pasi të kenë përfunduar regjistrimin e pasurive në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës.

Pronarët për të cilët në kolonën "Shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP (Vërt. hip)", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit për tokë truall dhe objekte (dyqan, objekte banimi, karabina) është 25 866 761 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I
SHPRONËSIMEVE
LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "URA E GAJDARIT-RRAP, SARANDË"

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr. pas.	Vërtip	Lloji i pasurisë					Sip Objekti m^2	Vlera totale (Lekë)	Shënime
							Trualll			Objekte				
							Sip. m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera (Lekë)	Lloji	Vlera (Lekë)			
1	Agim Avdul Musa		Dule Dule Musai	1722			36	12000	432000	Dyqan	3775695	194	4207695	Proces regj. fillestar konf.Zrpp
2	Thanas	Vaho	Naci	8642	25/98		195	12000	2340000	Banese	6151398	420	8491398	Proces Legalizimi-konf
3	Sheko	Mine	Xhuvani	8642	25/99		110	12000	1320000	Banese	3632855	107.5	4952855	Proces Legalizimi-konf
4	Xhemal	Resul	Cepe	8642	25/97		220	12000	2640000	Karab. 1k.	702813	59	3342813	Proces Legalizimi-konf
5	Simon	Josif	Cipa	8642		138	200	12000	2400000				2400000	konf. Zrpp (vert. hip)
6	Ilmir	Subi	Majka	8642		1	99	12000	1188000				1188000	konf. Zrpp (vert. hip)
7	Veli	Fiko	Hasani	8642		14	107	12000	1284000				1284000	konf. Zrpp (vert. hip)
	Totali						**967**		**11604000**		**14262761**	**780.5**	**25866761**	